



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E BUJQËSISË, PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
MINISTARSTVO POLJOPRIVREDE ŠUMARSTVA I RIPIA, NOG RAZVOJA
MINISTRY OF AGRICULTURE, FORESTRY AND RURAL DEVELOPMENT
Arkivi Qendror - Centralno Arhiva - Central Archive

Nr./Br./No. 269
Nr. i fq./Br. Str. No. pg. 7
Data/Datum/Date 29.01.2026
PRISHTINË - PRISTINA - PRISTINA

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS /VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i
Ruralnog Razvoja/Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë/ Agencije za Razvoj Poloprivrede/ The Agriculture
Development Agency

REFERENCË:	03.03.2026				
PËR/ZA/TO:	Venera Çerkinin, Sekretare e Përgjithshme e MBPZHR				
CC:	Albina Tolaj, Ilir Musliu, dhe Imer Limani				
PËRMES/PREKO/THROUGH:					
NGA/OD/FROM:	znj. Nysrete Doda - Gashi , Kryesuese e komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për PZHR-2024 <i>L.Doda - Gashi</i>				
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti i Komisionit për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen e ankesave për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2024				
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	3/1	Lokacioni: Kucni: Extension:	Prishtinë	Data: Datum: Date:	29.01 2026
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOST/FOR ACTION					☒
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL					☐
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE					☐
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION					☒
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE					

Në bazë të Vendimit të datës 17.03.2025, me nr. ref. ZSP-172/25, nr. 136, pika 4, sipas së cilës:

“Komisioni nga pika 1 dhe 2 e këtij vendimi obligohet që për punën e vet dhe për veprimet e marra të hartojë procesverbal dhe raport pune me shkrim për Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural”,

Komisioni për shqyrtimin, vlerësimin dhe vendosjen e ankesave për Projektet e Zhvillimit Rural për vitin 2024, në përbërje:

- Nysrete Doda-Gashi – Kryetare
- Albina Tolaj-Balaj – Anëtare
- Tahir Halitaj – Anëtar
- Ilir Musliu – Anëtar
- Imer Limani – Anëtar

paraqet këtë raport pune.

Baza ligjore e punës

Komisioni ka vepruar në përputhje me Udhëzimin Administrativ (MBPZHR) nr. 32/2024 për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillimin rural për vitin 2023, i nënshkruar nga Ministri i MBPZHR-së, z. Faton Peci, më datë 17.12.2023.

Thirrjet për aplikim

Për Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural janë shpallur dy thirrje për aplikim:

- Thirrja e parë për Programin e Zhvillimit Rural 2024, e hapur nga data 27.12.2024 deri më 27.01.2025;
- Thirrja e dytë, vetëm për Masën 5 – “Përgatitja dhe zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal – Qasja LEADER”, e hapur nga data 20.05.2025 deri më 20.06.2025.

Periudha e punës së Komisionit

Me shpalljen e përfituesve të parë të mundshëm dhe me paraqitjen e ankesave të para, Komisioni ka filluar punën në fund të muajit prill 2025 dhe ka vazhduar deri në përfundimin e shqyrtimit të të gjitha lëndëve në dhjetor 2025.

Të dhëna të përgjithshme

- Numri i përgjithshëm i aplikuesve: 1,072
- Numri i përfituesve përfundimtar: 463

Figura 1. Numri i përgjithshëm i aplikuesëve dhe përfituesit përfundimtar




Figura 2. Numri i ankesave dhe përqindja e ankesave në numrin e përgjithshëm të jo përfitueseve





Figura 3. Numri i ankesave sipas Masave të PZHR 2024



Numri më i madh i ankesave është regjistruar në Masën 1 – Investime në asete fizike të ekonomive bujqësore (175 ankesa), ndërsa në Masën 3 – Investime në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore janë regjistruar 19 ankesa.


Numri i ankesave sipas masave dhe nën masave

a) Masa 1 - Investime në asete fizike të ekonomive bujqësore

MASA 1	Nën - masat	aprovime	refuzime	gjithsej
	1.1 Pemë drufrutore	1	13	14
	1.2 Arra, lajthia dhe gështenja	3	4	7
	1.3 Pemë manore	1	2	3
	1.4 Sektori i perimeve dhe serrave, përfshirë serrat për fidanë	3	17	20
	1.5 Depo për ruajtjen e pemëve dhe perimeve	5	9	14
	1.6 Prodhimi i mishit / rritja e viçave	2	21	23
	1.7 Prodhimi i mishit / rritja e derrave	0	0	0
	1.8 Prodhimi i qumështit/lopë	19	44	63
	1.9 Prodhimi i qumështit / dele dhe dhi	1	6	7
	1.10 Pikat grumbulluese të qumështit	0	2	2
	1.11 Prodhimi i rrushit	1	12	13
	1.12 Prodhimi i vezëve	2	3	5
	1.13 Drithërat	0	4	4
	Aprovuar/refuzuar -gjithsejt	38	137	175

Siç shihet nga tabela e më sipërm numri më i madh i ankesave ka qenë në nën – masën 1.8. Prodhimi i qumështit/lopë 63 dhe në nën –masën 1.6 Prodhimi i mishit / rritja e viçave 23 që gjithashtu numrin e aplikacioneve që ka qenë më i madh në këto dy nën –masa

MASA 1




b) Masa 3 - Investime në asete fizike në përpunimin dhe në tregtimin e produkteve bujqësore

MASA 3	Nën - masat	aprovime	refuzime	gjithsej
	3.1 Përpunim qumështi	1	3	4
	3.2 Përpunim mishi	2	7	9
	3.3 Përpunimi i mishit të shpezëve/investime në thertore	0	1	1
	3.4 Përpunimi i pemëve dhe perimeve	1	2	3
	3.5 Prodhimi i verës	0	0	0
	3.6 Pika Grumbulluese /Depo	0	2	2
	Aprovua /refuzuar – gjithsej	4	15	19


Siç shihet nga tabela e më sipërm numri i më i madh i ankesave ka qenë për nën –masën 3.2 Përpunim mishi 9, gjithashtu edhe numrin e aplikacioneve që ka qenë më i madh në këto dy nën -masa.

MASA 3



Komision ka shqyrtuar gjithsej 194 ankesa, prej të cilëve nga ana e komisionit janë aprovuar 42 ankesa.

numri i ankesave	194
gjithsej të aprovuar	42
përqindja e lëndëve të aprovuar nga komision	21.65%



Sfidat me të cilat është ballafaquar Komisioni i ankesave gjatë punës së tyre:

- Gjatë ushtrimit të detyrave të tij, Komisioni është ballafaquar me këto sfida kryesore:
- Kushtet e papërshtatshme të punës, të cilat, pavarësisht njoftimeve të përsëritura zyrtare, nuk janë përmirësuar;
- Mungesa e hapësirës adekuate për mbajtjen e takimeve, mungesa e pajisjeve bazike të punës dhe mungesa e një laptopi për Komisionin;
- Zhvillimi i punës në zyra të përbashkëta në AZHB, me praninë e personave të tjerë, çka ka penguar konfidencialitetin dhe efikasitetin;
- Nevoja për bartjen fizike të dosjeve për shkak të mungesës së hapësirës së qëndrueshme të punës;

- Afatet e shkurtra ligjore për kthimin e përgjigjeve (1 muaj), të cilat në periudha me fluks të madh ankesash kanë qenë të vështira për t'u respektuar;
- Anëtarët e Komisionit kanë ushtruar paralelisht edhe detyrat e rregullta të vendit të tyre të punës;
- Puna e Komisionit është zhvilluar kryesisht me 4 anëtarë, për shkak të mungesave të shpeshta të njërit anëtar.

Anëtarët e komisionit

Nysrete Doda-Gashi N. Doda - Gashi

Albina Tolaj Albina Tolaj

Ilir Musliu Ilir Musliu

Imer Limani Imer Limani